



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vitisë – Opstina Vitina



Duke u bazura ne nenin 50.1 germa a dhe nenet 51.1 dhe nenit 58 LVQL nenit 12 pika 4 te L.SG.C.kontrates te dates 27-05-2016 te lidhur ne mes Komunes se Vitisë dhe Demos – Helvetas-Swiss intercooperation Kryetari i Komunes shpallë:

KONKURS PËR ANGAZHIM AFATSHKURTËR (Tre (3) Jurist në cilësi të evidentuesve)

Projekti: Komuna e Vitisë- Evidentimi i Pronave Komunale

Datë: 20 Qershor 2016

QËLLIMI I PROJEKTIT

Duke u bazuar në përvojën dhe statistikat zyrtare, në Komunën e Vitisë është më se evidente se ekziston një numër i konsiderueshëm i pronave komunale për të cilat mungon evidence e saktë për gjendjen dhe statusin e tyre të përdorshmërisë. Prandaj, synim i komunës është që të adresojë këtë problematikë dhe në të njëjtën kohë të përmirësojë evidencën e pronave komunale nga aspekti i gjendjes aktuale në të cilën gjendet secila pronë komunale.

Për të realizuar këtë synim, Komuna Vitisë do të angazhojë 3 (tre) evidentues/jurist për evidentimin e pronave komunale në gjithë territorin me angazhim afatshkurtër prej 3 (tre) muaj apo 66 ditë pune.

Përshkrimi i projektit

Me anë të këtij projekti, komuna synon të përmirësojë regjistrin e pronave komunale duke evidentuar saktë gjendjen aktuale të përdorshmërisë së secilës pronë, si dhe ta rrisë efikasitetin e shfrytëzimit të pronës komunale për të mirën publike. Kjo synohet të arrihet duke verifikuar fizikisht statusit e secilës pronë komunale, pra duke evidentuar nëse prona është:

- Në shrytëzim;
- E lirë, apo;
- E zënë.

Me qëllim që projekti të përmbush synimin e përcaktuar, kandidatët e përzgjedhur do të mbështeten me:

- Udhëzimet rreth lokacioneve;
- Trajnime;
- Hartat dhe pajisje të nevojshme; dhe
- Formularë dhe dokumente të nevojshme për kryerjen e detyrave të evidentimit.

Përshkrimi i detyrave të juristit në cilësinë e evidentuesit

Secili nga evidentuesit/juristët e përzgjedhur do ta ndjekë në tërësi trajnimin mbi evidentimin e pronave komunale, si dhe udhëzimet përcjellëse në lidhje me punën në teren.

Në bazë të udhëzimeve të zyrës për pronë dhe drejtorisë së financave, kandidatët e përzgjedhur duhet të realizojnë regjistrimin e pronave të paluajtshme në qytet, lagje, dhe fshatra përkatëse, sipas planit të veprimit të përcaktuar nga komuna dhe projekti DEMOS.

Poashtu kërkohet të bëhet raportimi i rregullt tek zyrtarët komunalë dhe përfaqësuesi i projektit DEMOS, mbi zhvillimet në terren dhe mbi rezultatet e arritura gjatë punës në teren.

E gjitha puna e sipërpërmendur duhet të përfundojë deri më **30 Tetor, 2016**, përfshi këtu edhe trajnimin 1 mujor.

Kriteret minimale që duhet të plotësojnë kandidatët jurist

- Të ketë të perfunduar fakultetin Juridik, ose të jetë së paku student i vitit të fundit
- Përparsi kanë kandidatet me përvojë në evidentim të pronave ose në kadastër
- Përparësi kanë kandidatët që kanë bërë punë terreni në të kaluarën
- Përvojë në angazhim me institucionet shtetërore
- Përparësi kanë kandidatët që zotojnë gjuhën Serbe
- Te kete aftësi komunikative, i qarte, konciz dhe bashkëpunues me qytetarë.
- Të ketë aftësi kompjuterike të paketës së Microsoftit s: Excel, Word dhe Access.

Afati i konkurrimit

Afati i konkurrimit është **8 ditë**, **20-06-2016 -27-06-2016** nga dita e shpalljes së konkursit.

Dorëzimi i dokumentacionit

Kandidatet duhet të dorëzojnë biografinë e tyre (CV) së bashku me kopjet e diplomave të shkollimit, dhe së paku një rekomandim/referencë nëse posedon në adresën zyra e arkivit komunal nr.1 më së largu deri me datën e përcaktuar me afatin e konkurrimit:

Personi kontaktues

Hysen Ymeri - Shef i Personelit në Komunën e Vitisë

e-mail: hysen.ymeri@rks-gov.net

telefoni: 0280-381-520

adresa: Viti

Vini Re: Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen për intervistim.

Kryetari i Komunës

Sokol Haliti